LIGJ
Nr.10 097, datë 19.3.2009

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 "PËR URBANISTIKËN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni l

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, në fund të nenit 51 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit paguhet 0,1 për qind e vlerës së investimit, që depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor, por, në çdo rast, jo më e vogël se vlera e nevojshme për të financuar studimet, që pushteti vendor duhet të bëjë për këto investime të infrastrukturës, përveçse kur është parashikuar ndryshe në ligje të veçanta.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6124, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi